

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA.
 me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Vesel Ismaili, kryetar dhe anëtarët Valbona Musliu-Selimaj dhe Naime Jashanica, gjyqtarë profesionistë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nurije Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarave _____ dhe _____ nga _____ për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, tani Prokuroria, Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PP/1.nr.390-5/2007, të dt.08.10.2007, pas zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit Ferdane Sylejamni, të akuzuarve: _____ me mbrojtësin e tij av. _____ dhe _____ me mbrojtësin e tij _____ me datë 22.03.2018, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

_____, i biri i _____ dhe _____ e gjinisë _____ i lindur më dt. _____ në _____ ku edhe tani jeton, me adrese ne Rr. " _____ " pa nr. Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka te kryer shkollën e mesme, _____ i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, më pare i pa dënuar ndaj tij nuk zhvillohet procedure tjetër penale, ka qene nene masën e paraburgimit prej dt. 31.05.2017, deri me dt. 27.06.2007.

_____, i biri i _____ dhe _____ e gjinisë _____ i lindur me dt. _____, ne fsh. _____ Komuna e _____ ku edhe tani jeton, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka te kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i pa martuar i gjendjes së dobët ekonomike, me pare i pa dënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedure tjetër penale.

Janë fajtor

I akuzuari

Sepse:

Me dt. 28.05.2007, rreth orës 17:30, ne rrugën " _____ ", në afërsi te " _____ " në _____, për shkak të një konflikti të mëhershëm në mes te pandehurit _____, ne njëren ane dhe vëllait te tani te pandehurit _____ ne anën tjetër, e derisa tani i pandehuri pasi që ka zbrit nga autobusi, ka vërejtur te pandehurin _____ i cili ishte në drejtim të kundërt të rrugës që shpien për Podujeve, dhe lëvize me traktor, i njëjti për një moment e ka ndale traktorin dhe me sëpatë ne dore, ka kaluar ne mes rrugës, duke shkaktuar tollovi në komunikacion derisa i është ofruar të pandehurit _____ 3-4, metra afër, me dashje me qellim te frikësimit ka përdorur armen e ftohtë sonatën duke ju kanosur te pandehurit _____ me çë rast posa i pandehuri ka vërejtur rrezikun që po i kanosej, ka nxjerr revolen e tipot " Berat " më nr. Serik F 47672, kalibër 9 mm, të cilës ia ka fute fishekët ne tyte, e ka repetuar më qellim që ta frikësoj dhe ta zmbrespse sulmin e at çashëm, por pasi ne atë moment që te dy kane vërejtur një automjet te policisë i lanë lëshuar armët poshtë dhe kane filluar te bisedojnë me pjesëtarët e ShPK-së.

- Me këtë ka te kryer veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te pa autorizuar te armeve nga 328 par 1, te KPPK-se.

I akuzuari

Deri me datën 28.05.2007, ka mbajtur revolen e tipit " Berta", me numër serik F47672, kalibër 9 mm, te cilin ditën kritike e ka nxjerr dhe repetuarin, me qëllim që të njëjtin ta frikësoj te pandehurin dhe ta zbraps sulmin e atë çashëm.

- Më këtë kishte për te kryer veprën penale mbajtja ne pronësi, ne kontroll dhe shfrytëzim te pa autorizuar te armeve nga neni 328 par 1, te KPRK-së.

Prandaj gjykata konform nenit 3, 4, 41, 43, 46, dhe neni 328 par.1 të KPK-së, si dhe 359, 365 366, të KPPK-së, i shqipton

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit i shqiptohet dënimi me burgim 1 (një) vit, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse ne afat prej 2 (dy) viteve, i akuzuari nuk do te kryen vepra te tilla, apo çfarë do vepre tjetër penale, ne rast te revokimit te dënimit me kusht koha e kaluar paraburgim nga data 31.05.2017, deri me dt. 27.06.2007, do ti llogaritet ne shqiptimin e dënimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore ti paguaj aq sa do të bëhen sipas fletëshpenzimes së kësaj gjykate , kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **50 (pesedhjetë) Euro**, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

DËNIMI PLOTËSUES

Konform nenit 62 dhe 69 të akuzuarit i konfiskohet sopata si mjet i kryerjes se veprës penale.

Te akuzuarit i shqiptohet dënimi me burgim 1 (një) vit, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse ne afat prej 2 (dy) viteve, i akuzuari nuk do te kryen vepra te tilla apo çfarë do vepre tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore ti paguaj aq sa do të bëhen sipas fletëshpenzimes së kësaj gjykate, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **50 (pesedhjetë) Euro**, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë

DËNIMI PLOTËSUES

Konform nenit 62 dhe 69 të akuzuarit i konfiskohet revolja e tipit " Berta" me numër serik F47672, kalibër 9 mm.

ARSYETIM

Ish Prokuroria Publike e Qarkut ne Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.390-5/2007, te dt. 08.10.2007, i ka akuzuar të akuzuarit për veprën penale vrasje ne tentative nga neni 147, par 1, nen par 9, lidhur me nenin 20 te KPPK-së, dhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, ne kontroll dhe shfrytëzim te pa autorizuar te armeve nga neni 328 par 1, te KPRK-së

Lidhur me këtë çështje penale gjykata e konfirmuar aktakuzën, ka zhvilluar seancën e shqyrtimit gjyqësor, ne te cilën seancë te shqyrtimit gjatë të cilit prokurorja e shtetit Ferdane Sylejmani pas leximit te dispozitivit te aktakuzës, e ka bere ricilsimin e veprës penale ndaj te akuzarit,

nga neni 147 par 1, nen par. 9, lidhur me nenin 20 te KPPK-së, ne veprën penale, neni 328 par 1, te KPPK-së.

Pas leximit te dispozitivit te aktakuzës nga ana e prokurorit te shtetit, te akuzuarit deklarojnë: se e kane kuptuar akuzën, veprat penale për te cilat akuzohen, nuk kane nevojë për ndonjë sqarim shtesë, dhe pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre, duke i kuptuar pasojat dhe bëni fitet e pranimit te fajësisë për kryerjen e veprave penale qe te akuzuarit e pranojnë fajësinë për veprën penale.

Mbrojtësi i te akuzuarit **avokati** ka theksuar se pajtohet me pranimit e fajësisë se te mbrojturit tim dhe i propozoj gjykatës ta aprovoj pranimitin.

Mbrojtësja e te akuzuarit **av.** ka deklaruar se pasi qe i mbrojturi im, ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihete ne barre kërkoj nga ju që gjate shqiptimit të dënimit te kenë parasysh o pranimitin e fajësisë nga neni 248, te KPPK-së, si rrethane lehtësuese, dhe se i mbrojturi im është i vetëdijshëm për benifitet dhe pasojat e pranimit te fajësisë.

Prokurori i shtetit thekson se pajtohet me pranimitin e fajësisë se te akuzuarve i cili pranimit është ne pajtim me provat qe gjenden ne shkresat e lendes dhe i ka propozuar gjykatës qe te aprovoj pranimitin e fajësisë.

Trupi gjykues pasi i shqyrtoj, i analizoj pranimitet e fajësisë për kryerjen e veprave penale nga ana e te akuzuarve dhe mendimin e prokurorit te shtetit lidhur me pranimit fajësisë nga ana e te akuzuarve konform nenit 326, par 1, te KPPK-se, aprovoj pranimitin e fajësisë nga ana e tyre, fare nuk u leshu ne procedurën e administrimit te provave, por kaloj ne fjalën përfundimtare te palëve ne procedure.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare deklarone: se pasi qe te dyte akuzuarit e pranuan fajësinë për kryerjen e veprave penale për te cilat akuzohen, i cili pranimit vërtetohet edhe ne provat qe gjenden ne shkresat e lendes, andaj i propozoj gjykatës qe te njëjtit për veprat e kryera penale ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i te akuzuarit **av.** pasi qe i mbrojturi im e pranoj fajësinë për kryerjen e veprës penale për te cilën akuzohet, i propozoj gjykatës qe ketë pranimit te fajësisë me rastin e caktimit dhe matjes se dënimit ta merr si rrethane posaçërisht lehtësueses, gjithashtu moshën e tij ne kohen e kryerjen e veprës penale, qe ka qene 18 vjeçar, as kësaj kohe nuk ka kryer asnjë vepër tjetër penale, andaj mbrojta konsideron se me një demin te kushtëzuar do te arrihet qëllimi dhe efekti i dënimit.

I akuzuari **ne fjalën përfundimtare deklarone:** e përkrahi ne tersi fjalën e përfundimtare te mbrojturit tim, pendohem jashtëzakonisht telle, për kryerjen e kësaj vepre penale, i premtoj gjykatës qe ne te ardhmen nuk do te përsëris vepre te tilla apo çfarë do qofshin ato, me të akuzuarin dhe familjarët e tij jemi pajtuar, jemi kushërinjë ne mes vete, dhe tani nuk kemi asnjë te keqe ne mes veti, e lus gjykatën, qe te me shqiptoj një dënim sa me te bute te mundshëm.

Mbrojtësja e te akuzuarit **av** ne fjalën përfundimtare deklarone: i propozoj gjykatës qe ta merr parasysh pranimitin e fajësisë si rrethane lehtësues, duke

marr parasysh se vepra është kryer ne vitin 2007, e qe nga atëherë kane kaluar me shume se 11, vite, se dy te akuzuarit tanimë kane raportet mira, janë kushëri ne mes veti, andaj i propozoj gjykatës qe te shqiptoj nje dënim sa me te but mundshëm dhe dënim me gjobe.

I akuzuari ne fjalën përfundimtare deklaron: e përkrahi ne tërësi fjalën përfundimtare te mbrojtëses time, me dhe familjen e tij jemi pajtuar, para këtij rasti dhe pas këtij rasti nuk kemi pasur konflikte apo mos pajtime.

Gjykata me rastin e vlerësimit te gjendjes faktike, edhe pse te akuzuarit e pranuan fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale, i shqyrtoj dhe i analizoj te gjitha provat materiale te cilat gjendjen ne shkresat e lendes një nga një dhe te gjitha se bashku, andaj konstatoi ne mase te mjaftuar se i akuzuarit dhe kane kryer veprën penale mbajtja ne pronësi kontroll, në posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armeve, nga neni 328 par.1, te KPPK-së, dhe te njëjtit i shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes se vendimit, mbi shqiptimin e dënimit, llojin dhe lartësinë, për të akuzuarit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 74 të KPK-së. Për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese mori moshën e tij relativisht te re ne kohen e kryerjes se veprës penale, me te akuzuarin dhe familjaret e tije jane pajtuar, se me pare nuk ka qene i dënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, se është i gjendjes se dobët ekonomike, se tani është i martuar dhe baba i fëmijëve te mitur, por si rrethane posaçërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë, për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethane renduese Gjykata mori parasysh peshën e rend te veprës penale.

Ndërsa për te akuzuarin si rrethane lehtësuese mori se me pare nuk ka qene i gjykuar dhe se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, se me te akuzuarin janë pajtuar, gjendjen e tij te dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale, kurse si rrethana renduese mori parasysh peshën e rend te veprës penale.

Andaj gjykata konsideron se ky dënim është adekuatë me shkallen dhe përgjegjësinë e veprës penale, e rrezikshmërisë për veprat penale, shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar sipas dispozitës së nenit 41 të KPK-së, e që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK. Ndërsa mbi konfiskimin është marrë konform nenit 62 lidhur me nenin 69 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, dhe nenit 328, par 1, te KPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË –DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
P.nr. 541/07dt.22.03.2018

Procesmbajtësja
Nuriye Rexhebeqa

Kryetari I trupit gjykues - Gjyqtari
Vesel Ismaili

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.